



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

THIRRJE PUBLIKE PËR ANGAZHIM TË KONSULENTËVE DIGJITAL NË KUADËR TË PROJEKTIT PËR DIGJITALIZIM OEK – ITP

Konteksti i projektit

Oda Ekonomike Kosovës (OEK), është organizatë profesionale e themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës. Është institucioni i vetëm i biznesit i themeluar me ligj dhe veprimtaria e OEK-ut zhvillohet mbi bazën e këtij Ligji (Ligji mbi Odën Ekonomike të Kosovës 2004/7) i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. OEK është institucion në shërbim të ekonomisë kosovare, partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira makroekonomike. Oda Ekonomike e Kosovës analizon gjendjen ekonomike të Kosovës dhe aktivisht propozon forma të reja dhe të avancuara të biznesit vendor dhe bënë ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare.

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) në bashkëpunim me Parkun për Inovacion dhe Trajnim (ITP) kanë hyrë në partneritet që ka për qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat përmes transformimit digjital. Ky partneritet vjen si vazhdimësi e partneritetit strategjik me GIZ Kosova mbështetur nga Qeveria Gjermane në kuadër të projektit për Krijimin e Punësimit Përmes Promovimit të Eksportit.

Komponenti kryesor i këtij partneriteti në mes OEK dhe ITP është krijimi i strategjive digjitale për NVM-të Kosovare. Në kuadër të këtij partneriteti, OEK do të angazhojë Konsulentë Digjital të Certifikuar të specializuar në tre module, për të ju shërbyer nevojave të kompanive:

- Certified Digital Transformation Expert (Ekspert i certifikuar në Transformim Digjital)
- Certified E-commerce and Social Media Expert (Ekspert i certifikuar në modulën E-commerce /platformat e shitjes online dhe media sociale)
- Certified IT Security Expert (Ekspert i certifikuar në modulën e Sigurisë së TI dhe kibernetike)

Oda Ekonomike e Kosovës si rezultat i projektit të mëparshëm me GIZ Kosova ka përfunduar studimin e parë bazë mbi statusin e digjitalizimit në Kosovë, trajnimin dhe certifikimin e gjeneratës së parë të konsulentëve digjital në Kosovë. Në projektin e ri me ITP do të vazhdojë me angazhimin e konsulentëve digjital për nevoja të këtij projekti.

Angazhimi i ekspertëve/konsulentëve do të bëhet për dy procese:

1. Analiza e ekspertëve (dy ditë pune për ekspert/për kompani)
2. Zhvillimi i strategjisë digjitale (tre ditë pune për ekspert/për kompani)

Kompanitë të cilat do të kalojnë në këto dy procese do të jenë nga sektori i prodhimit, agrobiznesit dhe shërbime. Kompanitë do të aplikojnë përmes Qendrës për Transformim Digjital(nënfaqe ne kuadër të webfaqes së OEK) apo përmes postës elektronike duke dorëzuar format e nevojshme të aplikimit për t'i përfituar këto shërbime.

Projekti mbulon financiarisht 120 ditë pune për analizën e ekspertëve dhe 180 ditë pune për zhvillimin e strategjisë digjitale.

Ndarja e ditëve për konsulent do të bëhet varësisht nevojave(fushës) të kompanive të cilat aplikojnë.

Të gjitha profilet e konsulentëve të përzgjedhur do të përfshihen në nënfaqen e Qendrës për Transformim Digjital(në kuadër të webfaqes së OEK), përmes së cilës kompanitë mund të marrin të gjitha informatat rreth projektit dhe të aplikojnë 'online' për të kaluar në dy fazat e lartpërmendura.

Kush mund të aplikojë

Të gjithë interesuarit që plotësojnë kriteret e kësaj thirrje mind ti dorëzojnë dokumentet e kërkuara(të skanuara) në dt@oek-kcc.org deri më **21.05.2021**. Kandidatat e përzgjedhur do të përfshihen në projektin e OEK – ITP sipas nevojave dhe kohëzgjatjes së projektit. Konsulenti duhet të përcaktojë modulën në të cilin po aplikon në formën e aplikacionit(të vendosur në annex të kësaj thirrje) dhe të njejten ta shkruajë në subjektin e e-mailit.

Kriteret për aplikim

- Të jetë i pajisur me certifikatë konsulence në modulën e përzgjedhur.
- Të ketë eksperiencë/përvojë pune në fushën e digjitalizimit.
- Të ketë shkollim adekuat(niveli Bachelor, Master apo PhD).
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në ekip.

Si kriter i përzgjedhjes do të jetë 70% tabelat e vlerësimit të kompetencave dhe 30% oferta financiare.

Dokumentet për aplikim

- Dy referenca profesionale
- CV apo portfolio e punës
- Certifikata e specializimit si konsulent digjital
- Oferta financiare për ditë pune/angazhim
- Aplikacioni i plotësuar/ përcaktimi i modulit të përzgjedhur.

Përshkrimi i kompetencave të konsulentit

Konsulentët e secilit modul duhet të:

- Posedojnë njohuri të gjera për trendet digjitale, mundësitë dhe risqet lidhur me transformimin digjital.
- Jenë në gjendje të njohin potencialet digjitale të klientëve.
- Jenë në gjendje të përcaktojnë nivelin e maturisë së një kompanie në procesin e transformimit digjital.
- Jenë në gjendje të zhvillojnë dhe monitorojnë strategjitë e transformimit digjital.
- Njohin shanset dhe të mund të monitorojnë implementin teknik dhe zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe modeleve të biznesit.
- Të posedojnë aftësi të buta “soft skills”.
- Të jenë inovativ dhe të jë sjellin risi në të gjitha fushat për të krijuar vlerë të shtuar për klientët.

Njohuritë specifike për Certified Digital Transformation Expert

- Digjitalizimi
- Modelet e Biznesit Digjital
- Transformimi dhe Lidhshipi Digjital – aspekti kulturor në transformimin digjital
- Zingjiri i vlerës dhe menaxhimi – transformimi digjital nëpër kompani
- Marketingu digjital – të njohurit e klientit në aspektin digjital
- Njohuri për Sigurinë e Teknologjisë Informative

Njohuritë specifike për Certified E-Commerce and Social Media Expert

- Trendet në biznesin elektronik
- Shitja & Transformimi Digjital
- Tregtia: nga dyqani në platforma online
- Big Data: nga të dhënat tek informacioni
- Marketingu Online: nga SEO tek mediat sociale

Njohuritë specifike për Certified IT Security Expert

- Konsideratat Themelore Strategjike të TI dhe Menaxhimi i Rrezikut
- Masat e Personelit & Menaxhimi Themelor i Operacioneve të IT
- Kërkesat ligjore: Bazat e mbrojtjes së të dhënave
- Të drejtat dhe detyrimet sipas GDPR
- Privatësia dhe pajtueshmëria me IT
- Mbrojtja e të dhënave
- Siguria e rrjetit
- Rezervimi i të dhënave dhe menaxhimi emergjencave
- Masat strukturore dhe infrastrukturore

Tabela e vlerësimit

Kriteret	Vlerësimi					Komentet
	1	2	3	4	5	
Përvoja specifike dhe relevante e punës						
Niveli i edukimit						
Përfundimi i trajnimit dhe certifikimi						
Si CDTE, CESE ose CITSEC						
Ekspierencë në procesin e transformimit digjital të kompanive						
Njohuritë e përgjithshme dhe specifike sipas përshkrimeve të moduleve						
Total						

Tabela e lartpërmendur do të përdoret 70% si kriter i përzgjedhjes ndërsa 30% tjetër do të jetë oferta financiare.

Raportimi

Konsulentët e përzgjedhur do të raportojnë tek Menaxheri i projektit OEK – ITP dhe Menaxhmenti i OEK. Konsulentët do të punojnë ngushtë me kompanitë dhe do të mund të koordinohen bashkë për çështje që lidhen me analizën e ekspertëve dhe zhvillimin e strategjive digjitale. Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, konsulentët duhet të përgatisin raport pune lidhur me progresin e punës që shërben për nevoja të OEK dhe ITP.

Ankesat

Secili aplikues ka të drejtë ankese të cilën mund ta drejtoj tek dt@oek-kcc.org brenda 5 dite pas pranimit të përgjigjes në lidhje me rezultatin e përzgjedhjes.

Forma e aplikimit

Në cilësinë e konsulentit digjital, deklaroj se përcaktohem për të dhënë angazhimin tim sipas kërkesave të projektit, në modulin e mëposhtëm:

- Certified Digital Transformation Expert (Ekspert i certifikuar në Transformim Digjital)
- Certified E-commerce and Social Media Expert (Ekspert i certifikuar në modulin E-commerce /platformat e shitjes online dhe media sociale)
- Certified IT Security Expert (Ekspert i certifikuar në modulin e Sigurisë së TI dhe kibernetike)

Gjithashtu deklaroj se edhe në qoftë se jam i/e punësuar me orar të plotë, do të ofroj angazhimin tim për kohën e përcaktuar në projekt për analizën e ekspertëve dhe zhvillimin e strategjive digjitale.

Emri dhe mbiemri:

Data:

Nënshkrimi: